

VENDIM
Nr. 105, datë 5.2.2020

**PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË VENDIMIN NR. 641, DATË 6.11.2017,
TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR RUAJTJEN DHE MBROJTJEN E
ANËTARËVE TË INSTITUCIONEVE TË RIVLERËSIMIT KALIMTAR TË
GJYQTARËVE DHE PROKURORËVE, TË PERSONELIT VENDAS DHE
NDËRKOMBËTAR, TË OBJEKTEVE KU USHTROJNË VEPRIMTARINË, SI DHE
INSPEKTORIT TË PËRGJITHSHËM TË INSPEKTORATIT TË LARTË TË
DEKLARIMIT DHE KONTROLLIT TË PASURIVE DHE KONFLIKTIT TË
INTERESAVE, NGA GARDA E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të shkronjave “c” dhe “ç”, të nenit 4, të ligjit nr. 8869, datë 22.5.2003, “Për Gardën e Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr. 641, datë 6.11.2017, të Këshillit të Ministrave, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

a) Në titullin e vendimit, pas fjalëve “... , si dhe ...”, shtohen fjalët “... Inspektorit të Lartë të Drejtësisë dhe ...”.

b) Pas pikës 1 shtohet pika 1/1, me këtë përmbajtje:

“1/1. Garda e Republikës së Shqipërisë të ruajë e të mbrojë me truporë me oficer dhe nënoficer Inspektorin e Lartë të Drejtësisë.”.

2. Ngarkohen Ministria e Brendshme dhe Garda e Republikës së Shqipërisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletore Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe

